

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TË SHOQËRISË HTT-HIGH TECH TESTS SH.P.K

Politikat Kontabile dhe Shënimet Shpjeguese

Të dhëna për shoqërinë:

Shoqëria "HTT – HIGH TECH TESTS" Sh.P.K. është e regjistruar pranë QKR më datë 19.02.2014 me seli dhe vendodhje kryesore të aktivitetit në Njësinë Nr. 5, Rruga "Perlat Rexhepi", Pallati Nr. 6, kati 11, si dhe është shtuar adresa dytësore Fier; Lagjja 15 Tetori, Rruga "Miço Papuçiu", Pallati Firma Beton EG.

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: Verifikimi i të gjitha llojeve të matësave elektromekanike dhe elektronike të energjisë elektrike aktive dhe reaktive. Kalibrimi i Matësave Wlektrik dhe Madhësive të Tjera Elektrike. Inspektimi i Matësave Elektrik dhe Transformatorëve të Rrymës të Tensionit të Ulët etj.
Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë.

Administrator i shoqërisë është z. Genci Gjergjani.

Shoqëria është e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT L41419011B dhe ka një numër mesatar prej 39 punonjësish.

Të dhëna për Pasqyrat Financiare:

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me nenin nr. 4 të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare i ndryshuar si dhe me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292, datë 15.06.2006 "Për shpalljen e Standarteve Kontabël Kombëtare dhe zbatimin e detyrueshem të tyre". Kjo sepse shoqëria jonë plotëson kushtet që të zbatohet SKK.

Hartimi i tyre është bërë mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe parimit të vijimësisë duke respektuar karakteristikat e tyre cilësore:

- Kuptueshmërinë, për të qënë informuese për përdoruesit e tyre
- Rëndësinë, duke paraqitur vetëm atë informacion që ndikon në vendimet e përdoruesve
- Besueshmërinë duke dhënë informacionin e plotë, të paanshëm, të vlerësuar me kujdes ku përmbajtja ekonomike ka përparësi ndaj formës ligjore.

Përsa i përket kupueshmërisë janë të krahasueshme, janë aplikuar Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të cilat nuk zbatohen në retrospektive.

Janë përpiluar 4 pasqyrat kryesore:

1. Bilanci;
2. Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve;
3. Pasqyra e Fuksit të Parasë;
4. Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital;

Të katër pasqyrat janë përgatitur për periudhën 01.01.2018–31.12.2018, janë paraqitur në lekë pa përdorur rrumbullkim shifrash.

Për llogaritë që kanë patur transaksione në valute (euro, dollar dhe pound) tepricat e tyre janë ririvlerësuar më datë 31.12.2018 me kursin e bankës së Shqipërisë në këtë datë :

1 EUR= 123.42 lekë,
1 USD = 107.82 lekë;
dhe 1 GBP = 137.42 lekë.

Shënimet shpjeguese do të japin informacion të hollësishëm dhe të nevojshëm mbi pothuajse të gjithë zërat e pasqyrave.

Supozime dhe konsiderata, parimet dhe karakteristikat e informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë “HTT – HIGH TECH TESTS” sh.p.k. janë përgatitur sipas SKK1 ku pasqyrat financiare të shoqërisë përbëhen:

- a) Bilanci Kontabël
- b) Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve
- c) Pasqyra e Ndryshimit në Kapitalet e veta
- d) Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë
- e) Anekset e pasqyrave financiare që përmbajnë një paraqitje të metodave kontabël, si dhe materialin tjetër shpjegues.

Pasqyrat financiare ndërtohen duke u mbështetur në supozimet bazë, parimet dhe karakteristikat e informacionit kontabël.

Objekti i pasqyrave financiare është të japë një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të shoqërisë.

Këto pasqyra sipas SKK1 japin një pamje të vërtetë dhe të saktë kur të dhënat janë të sakta, përgatitja bazohet në vlerësime të arsyeshme dhe shënimet në pasqyrat financiare janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe të fluksit të parasë në mënyrë që përdoruesit mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.

Të dhënat për elemente dhe për shuma që ndikojnë në vendimmarrjet ekonomike të përdoruesve paraqiten veçmas në pasqyrat financiare.

Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijueshmërisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të ketë vijimësi dhe se shoqëria nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë, për një të ardhme të parashikueshme.

Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

Kompesimi ndërmjet një elementi të aktivitetit të bilancit dhe një elementi të detyrimeve, si dhe ndërmjet një të ardhure dhe një shpenzimi është i ndaluar.

Elementet futen në llogari dhe përfshihen në pasqyrat financiare, me shumatat që përcaktohen, sipas SKK.

Parimi i kujdesit

Ky parim nënkupton që pasqyrat financiare duhet të përgatiten me maturi dhe kujdes, me qëllim që të shmangët mbivlerësimi i aktiveve dhe i të ardhurave ose nënvlerësimi i pasiveve dhe i shpenzimeve. Në vlerësimet kontabile drejtuesit e shoqërisë e kanë shmangur

optimizmin dhe kanë marrë në konsideratë të gjithë faktorët që ndikojnë në vlerën e aktiveve dhe pasiveve në bilanc.

Parimi paanshmërisë

Pasqyrat financiare të përgatitura nga shoqëria japin një informacion të paanshëm dhe se nga mënyra si informacioni zgjidhet nuk influencon në arritjen e një rezultati të paracaktuar.

Parimi i krahasueshmërisë

Pasqyrat financiare duhet tu japin mundësi përdoruesve që të bëjnë krahasime ndërmjet ushtrimeve të ndryshme kontabël ose njësive ekonomike të ndryshme.

Paraqitja dhe klasifikimi i elementëve bëhen në koherencë nga një ushtrim kontabël në tjetrin, përveç rastit kur ndryshimi kërkohet nga një standart i ri kontabël ose kur ndryshimi çon në një paraqitje më të përshtatshme të ngjarjeve dhe transaksioneve në pasqyrat financiare të njësive ekonomike.

Parimi i paprekshmërisë së bilancit të çeljes

Bilanci i çeljes së ushtrimit është i saktë pasi rakordon me bilancin e mbyllur më datë 31.12.2017.

OPINIONE MBI LLOGARITE VJETORE TË VITIT 2018

Të ngarkuar me detyrën e Ekspertes Kontabile të Regjistruar kemi kryer testime në verifikimin e bilancit në përgjithësi nga pozicionet e jashtme dhe për parashikimin e risqeve, duke bërë teste të cilat i kemi çmuar të domosdoshme në referencë me normat profesionale si dhe tekstet ligjore dhe rregulluese në fuqi.

Për të arritur në opinionin përfundimtar ne kemi ushtuar kontrollin nëpërmjet testeve duke u mbështetur në planin e punës së hartuar paraprakisht si dhe shtesës së programit gjatë procesit të auditimit.

Organizimi i kontabilitetit

Organizimi i kontabilitetit dhe përgatitja e deklaratave financiare për ushtrimin e mbyllur me 31.12.2018 është bërë në përgjithësi konform Ligjit Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe se pasqyrat financiare janë përcaktuar qartazi sipas SKK2. Përpunimi i dokumentacionit dhe regjistrimet kontabile janë bërë në mënyrë kronologjike. Kontabiliteti është mbajtur në mënyrë kompjuterike me Program Finance 5. Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur ndryshime të politikave kontabile.

Vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale është bërë sipas SKK5, ku vlera kontabile neto është shuma (kostoja minus amortizimin e akumuluar) me të cilin njihet aktivi në bilanc.

Mbartjet e shumave të llogarive nga ditarët në centralizator dhe nga ky i fundit në pasqyrat financiare janë bërë pa gabime materiale.

Hartimi i deklaratave financiare është bërë sipas SKK2 në mënyrë korrekte duke i pasqyruar llogaritë sipas klasifikimit të këtij standarti në vartësi të natyrës së shoqërisë.

Përmbledhje e politikave të kontabilitetit

Deklaratat financiare të shoqërisë “HTT – HIGH TECH TESTS” SH.P.K për vitin 2018 janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe në përputhje me standartet SKK2.

Sipas kësaj metode efektet e transaksioneve dhe të ngjarjeve njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraqja arkëtohet), regjistrohen në kontabilitet dhe raportohen në

pasqyrat financiare të periudhave kontabile të cilave u përkasin. Monedha raportuese është Leku shqiptar ("Lek").

Politikat kontabile të reflektuara në deklarimet financiare të Shoqërisë janë si më poshtë:

Vlerësimet

Vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale është bërë sipas SKK5 ku aktivet afatgjata vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar, inventarët janë vlerësuar sipas SKK4 me shumën më të ulët mes koston dhe vlerës neto të realizueshme (VRN).

a) Aktive financiare afatshkurtra si dhe huat afatshkurtra

Llogaritë për t'u arkëtuar dhe për t'u paguar janë bërë sipas SKK3 dhe vlerësohen me koston e amortizuar e cila është e barabartë me vlerën nominale të kërkesës për arkëtim minus zhvlerësimin në rast se ka. Në fund të vitit është bërë rivlerësimi i tyre dhe diferencat janë paraqitur në bilanc sipas SKK12.

AKTIVI

Në aktiv në shënimin nr.1, është vlera e mjeteve monetare në bankë dhe arkë në vlerë **49'409'695** lekë, shifër kjo që i korrespondon datës 31.12.2018.

Gjendja e likuiditeteve rakordon me shumën e ekstratit të bankave dhe procesverbalin e arkës më datë 31.12.2018. Përkatesisht gjendja e mjeteve monetare në bankë është 41'624'836 lekë dhe gjendja monetare në arkë është 7'784'859 lekë .

I AKTIVET AFAT SHKURTERA

1 Aktivet monetare

Banka

Nr	Emri i Bankes	Monedha	Nr llogarise	Vlera ne valute	Kursi fund vitit	Vlera ne leke
	Raiffeisen Bank	ALL	0001036693	40,267,815	1	40,267,815
	Credins Bank	ALL	0000658079	784,243	1	784,243
	Raiffeisen Bank	EUR	0011036693	126	123	15,592
	Credins Bank	EUR	0000658081	3,929	123	484,891
	Raiffeisen Bank	USD	0021036693	777	108	83,760
	Credins Bank	USD	0000658080	- 106	108	- 11,465
Totali						41,624,836

Arka

Nr	E M E R T I M I	Vlera ne valute	Kursi fund vitit	Vlera ne leke
	Arka ne Leke	3,337,049	1	3,337,049
	Arka ne Euro	36,038	123	4,447,810
	Arka ne Dollare			
Totali				7,784,859

Për gjendjet në monedhën e huaj është bërë rivlerësimi i tyre me kursin në ditën e fundit të vitit sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Diferencat janë paraqitur saktë në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve sipas SKK12.

Në aktiv të bilancit në zërin kërkesa të arkëtueshme ndaj klientëve shënimi nr.2 me vlerë **132'603'404** lekë përfaqëson klientë të paarkëtuar, nga të cilët 132,559,827 lekë janë klient të paarkëtuar të vitit ushtrimor dhe 43,577 lekë janë klient të paarkëtuar të viteve të mëparshme ushtrimore.

Në aktiv të bilancit në postin e inventarit shënimi nr.5, paraqiten zëri i materialeve të para gjendje në vlerën **9'294'919** lekë, parapagime të bëra në vlerën **8'805'766** lekë, si dhe parapagim për dividend në vlerën **2'100'000**lekë.

Nga auditimi i kësaj rubrike rezultoi;

- Janë zbatuar konform normave dhe rregullave procedura e vlerësimit të stokut me çmimin e blerjes;
- Janë kryer rakordimet e inventarit kontabël me kartelat financiare e bilancin kontabël gjatë periudhës ushtrimore;
- Në lidhje me sasinë gjendje të datës 31.12.2018 ne nuk mund të shprehemi mbasi në këtë datë ne nuk kemi marrë misionin e auditimit.

Në aktiv të bilancit në postin Aktivet Afatgjata shënimi nr.6, 17 janë paraqitur AAM të cilat janë vlerësuar sipas SKK5, ku aktivet afatgjata vlerësohen me vlerën kontabile neto pra një aktiv njihet në bilanc (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi) dhe i përkasin kompanisë. Vlera e tyre neto është **79'144'559** lekë. Për vitin 2018 asetet e shoqërisë janë shtuar për vlerën fillestare **5'076'942** lekë dhe janë pakësuar nga shitjet në vlerën neto prej **7'548'048** lekë.

Në aktiv të bilancit në postin e aktiveve afatgjata jo materiale është regjistruar një program software në vlerën **201,498** lekë si dhe Emri i mirë i cili përbëhet nga Standardet e akredituara dhe Certifikuara të kompanisë në vlerën **846,469** leke.

PASIVI

Në pasiv të bilancit në shënimin nr.8 janë paraqitur detyrime ndaj furnitorëve dhe të tretë me vlerë **1'243'236** leke, ku kjo shumë e plotë përfaqëson detyrimet që ka kjo shoqëri ndaj furnitorëve për shërbimet e furnizimet e kryera.

Detyrimet ndaj punonjësve janë në shumën **6'286'747** lekë.

Detyrimet ndaj degës së tatimeve në vlerën **11'465'284** lekë përbëhen:

- Tatim mbi të ardhurat personale në vlerën 1,161,352 lekë
- Tatimi mbi vlerën e shtuar në vlerën 9'021'147 lekë
- Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore në vlerën 860'918 lekë
- Tatim në burim në vlerën 421'867 lekë

Në pasiv të bilancit në shënimin nr. 12 paraqitet kapitali si më poshtë.

Kapitali aksioner në vlerën prej 100,000 lekë.

Fitimi i vitit ushtrimor 44'779'371 lekë. Nga fitimi i vitit 2017, është vendosur me Vendimin nr.20 datë 25.06.2018 për të shpërndarë dividend në vlerën 152'173'125 leke.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Në shënimin nr.13 janë paraqitur të ardhurat e krijuara nga shoqëria nga aktiviteti saj në vlerë totale prej **234'158'974** lekë.

Në shënimin nr.14, janë paraqitur kostot e personelit që përbëhen nga pagat e personelit në vlerë **(53'604'677)** lekë dhe shpenzimet për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në vlerë **(5'746'418)** lekë.

Në shënimin nr.16, janë paraqitur shpenzimet administrative dhe të tjera për zhvillim e aktivitetit të shoqërisë në vlerë **(107'789'402)** lekë.

Në shënimin nr.17, janë paraqitur shpenzimet e amortizimit në vlerën **(15'902'501)** lekë.

Në shënimin nr.19, janë paraqitur shpenzime financiare të paraqitura në vlerën neto prej **(3'070'217)** lekë.

Shoqëria për vitin 2018 ka një rezultat neto në vlerën **44'779'371** lekë .

Evidenca e rezultatit financiar të shoqërisë është mbajtur konform parimeve të përgjithshme dhe të drejtave të konstatuara të kontabilitetit, ajo pasqyron të gjitha zërat e shpenzimeve dhe të të ardhurave sipas specifikave që ka subjekti.

Shpenzimet janë klasifikuar sipas kërkesave të SKK8, janë regjistruar në ditarët analitike përkatës dhe janë mbartur rregullisht në llogaritë e bilancit.

Tiranë më 30.03.2019.

HARTUESI

Dorina MUKA

ADMINISTRATORI

Genci GJERGJANI

